

V E N D I M
Nr.577, datë 6.12.1993

**PËR NDËRTIMIN, SHPËRNDARJEN DHE ADMINISTRIMIN E BANESAVE QË
NDËRTOHEN NGA NDËRMARRJET SHTETËRORE ME FITIMET E TYRE**

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

1. Ndërmarrjet shtetërore kanë të drejtë të ndërtojnë banesa për strehimin e punonjësve të tyre, duke përdorur si burim financiar fitimet e tyre.

2. Përfaqësues i shtetit në këto banesa do të jetë Enti Kombëtar i Banesave.

3. Ndarja e apartamenteve do të bëhet nga vetë ndërmarrja shtetërore, sipas listës së punonjësve që do të marrin apartament të ri dhe kushtit që mund të vendosë ndërmarrja për dorëzimin nëpërmjet shitjes së apartamentit të vjetër (ekzistues).

Ndërmarrja është e detyruar të respektojë të gjitha aktmarrëveshjet që qytetarët kanë lidhur me organet e pushtetit lokal për t'i strehuar në banesën që ndërton.

Organet e pushtetit lokal verifikojnë respektimin e këtyre aktmarrëveshjeve.

4. Vleftha e apartamenteve, për të cilat qytetarët kanë lidhur aktmarrëveshje me organet e pushtetit lokal, përballohet nga Enti Kombëtar i Banesave, nëpërmjet buxhetit të shtetit gjatë vitit pasardhës, vetëm për banesat në proces.

5. Për shitjen e apartamenteve punonjësve sipas listës së pikës 3 të këtij vendimi, Enti zbaton këto kritere:

a) Për banesat që përfundojnë në vitin 1993 e në vazhdim, por që kanë filluar para vitit 1993:

- në rast se punonjësi është i pastrehë, sipas dispozitave në fuqi, ose nuk ka përfutur nga ligji i privatizimit të banesave shtetërore, ai lidh kontratë për blerjen e apartamentit, në vlefthën e të cilit zbritet vleftha e punimeve të financuara e të situacionuara para vitit 1993;

- në rast se punonjësi ka përfutur nga ligji i privatizimit të banesave shtetërore dhe lidh kontratë për vlerjen e apartamentit, atëherë vleftha e apartamentit llogaritet e plotë sipas kostos reale në çastin e shitjes.

b) Kur banesa ka filluar gjatë vitit 1993 e në vazhdim, kontrata e shitjes nga ana e Entit lidhet në bazë të kostos reale të apartamentit në çastin e shitjes.

6. Punonjësit që kanë përfutur nga ligji i privatizimit të banesave shtetërore, para marrjes së apartamentit të ri, ndërmarrja mund të kërkojë dorëzimin nëpërmjet shitjes së apartamentit të vjetër, sipas vlefthës reale të përcaktuar nga një komision specialistësh të Entit, për t'ia shitur një punonjësi tjetër, në përputhje me kriteret e mësipërme.

7. Në të gjitha rastet lidhja e kontratës së shitjes së apartamenteve ndërmjet Entit dhe punonjësve bëhet sipas kontratës tip të Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi